



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL
NJESIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot

Bilisht, më _____._____.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Mbrojtje nga ujerat e larta dhe sistemimi i perroit te SMT”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV): Punime ndertimi per sisteme kullimi-45232450-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 43 588 214 (dyzet e tre milion e peseqind e tetedhjetë e tete mije e dyqind e katermbedhjetë) leke pa tvsh

Bazuar në projektin dhe preventivin e përlloritur të përgatitura nga Studio e Projektimit “HMK Consulting” SHPK

Kriteret e përgjithshme të pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Devoll** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:
 - a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3
 - b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin⁷⁶ ”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te Nenit 26 ”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga*

autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrata tatimore per vitet 2020,2021,2022 ,ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar **duhet te jome e vogel se vlera e kontrates objekt prokurimi.**

*** Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, te LPP, si dhe nenit 43, pika 2-b e VKM-se, nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku percaktohet se; “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:b) vlerën e përlogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 1, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,ku percaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Fondi limit = 43,588,214 lek pa TVSH.

2.2.2. Per te vertetuar nje aktivitet te qendrueshem Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

****Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. i ndryshuar mbi bazën e të cilave AK mund të kërkojë nga operatorët ekonomike pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin përfundime në bilancet e tyre vjetore për një periudhë maksimale tre vitesh e fundit financiare që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara është bërë duke iu referuar Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” ku përcaktohet se:- “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar rrapshikimit në nenin 41 shkronja c, të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) *totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrijn ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;*
- ii) *shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrijn ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;*
- iii) *ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha **detyrimet e taksave dhe tarifave vendore**, lëshuar nga Pushteti Vendor, e referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitetin sipas të dhënave të QKB-se **për vitin 2022 ose keestet e maturuara për vitin 2023**

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument në momentin e dorëzimit të dokumentave).

Shënim : Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitetin sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2022 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2023.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e LPP, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vendosija e kërkesës për detyrimet vendore është bërë në mbështetje të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Shlyerja e detyrimeve vendore për operatorët ekonomik pjesëmarrës vërteton se ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në përputhje me rregullat e përcaktuara nga autoritetet vendore nëpërmjet Vendimeve të Këshillave Bashkiak.

2.3 Kapaciteti teknik :

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së perlllogaritur te kontrates që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i fondit limit te kontrates që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

a.Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore;
- Aktin e kolaudimit;
- Certifikaten e marrjes në dorezim të perkohshëm/perfundimtar.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b. Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore;
 - Akt kolaudimi objekti.
- ✓ Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

✓ Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- a) Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
- b) Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe Nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, dt 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës objekt prokurimi për një objekt të vetëm, ose jo më e ulët se dyfishi i vlerës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Në rastet e Bashkimit te Operatoreve, për nje vlerësimin sa më real të ofertave, është konstatuar se Komisionet e Vlerësimit të Ofertave hasin vështirësi për vlerësimin në mënyre sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, në rastet kur në formularët e vlerësimit nuk përcaktohen përqindjet e pjesëmarrjes të secilit operator në bashkim, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private lëshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve), për rrjedhojë është e domosdoshme që Operatorët Ekonomik kur paraqesin kontrata të ngjashme, ku janë pjesë e një bashkimi operatoresh duhet të paraqesin gjithashtu dhe marreveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaceme ku të përcaktohen përqindjet përkatëse.

Në rastet e Nënkontraktimit, kërkohet që vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit për marrëveshjen e nënkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nënkontraktimit lëshuar nga AK. Ky dokumentacion disponohet nga çdo operator ekonomik si në rastin kur ka qene palë në bashkimin e operatoreve ekonomik ashtu dhe në rastet kur ka qenë Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk sjell kufizim të pjesmarrjes së operatoreve ekonomik në tender.

Të dyja këto kërkesa ivendosin në kushte të barabarta dhe u japin mundësi për vlerësim, të gjithë operatoreve ekonomik ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit dhe marrëveshjet përkatëse të nënkontraktimit nuk janë të plotësuara sipas kërkesave ligjore.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$43,588,214 * 50\% = 21,794,107 \text{ leke pa TVSH}$$

$$43,588,214 * 2 = 87,176,428 \text{ leke pa TVSH}$$

2.3.2/a Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjië, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **N.P - 1 A** Punime gjurmimi në tokë;
- **N.P - 7 A** Ujshjellësa, gazshjellësa, vajshjellësa, vepra kullimi e vaditje.
- **NP – 9 B** Punime për mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime (natyra e objektit)
- **NP. 12 – A** Punime të inxhinierisë së mjedisit

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **NS – 18 A** Punime topogjeodezike

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2 dhe 4).

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve dhe vlerën e përllogarit të kontratës.

NP - 1 A Punime gjurmimi në tokë

Konsiderohen gjurmimet, sistemet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv.

NP - 7 A Ujshjellësa, gazshjellësa, vajshjellësa, vepra kullimi e vaditje

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv ne teresi projekti është në kuadër të mbrojtjes të qytetit të Bilishtit nga ujrat e larta dhe shfrytëzimin e tyre për ujitjen e tokave buqesore një sipërfaqe prej rreth 600 Ha toke.

NP – 9 B Punime për mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime

Ne teresi ky projekt i dedikohet sistemit të ujrave sipërfaqesore dhe tokësore të cilat vijne nga pjesa e sipërme e qytetit.

Ndërtimi I vepra se marjes

Gjurmimi / mbushja për krijimin e seksionit të kanalit

Veshja me beton e seksionit të kanalit

Kalimi me tuba çeliku I rrugëve

Mure me gabiona

NP - 12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit

Gjatë ndërtimit të objektit referuar Raportit të VNM duhet të meren masa nga ana e Kontraktorit për të shmangur në maksimumin e mundshëm ndikimin në mjedis gjatë fazës së implementimit të projektit. Eliminimi I gjenerimit të pluhurave në ajër, shmangja e ndotjes të ujit nga

perdorimi I materjaleve ose nga furnizimi I papershtatshem me karburant I mjeteve. Ne preventiv eshte parashikuar zeri 3.158/4a (Transport I inerteve me auto)

Kontraktori duhet ti trasportoje ose ricikloje inertet sipas rastit ne nje vend depozitim te pershtatshem per llojin e materjalit qe po transportohet. Per te permbushur te gjitha kerkesat e mesiperme Kontraktori duhet te jete I pajisur me licensat perkatese referuar VKM Nr. 42, date 16.01.2008:

Për punimet speciale të ndërtimit :

NS – 18 A Punime topogjeodezike

Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh

Kjo kategori licence i referohet punimeve topografike të parashikuara në projekt.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P - 1 A	Punime gërmimi në tokë	3.89/a;3.122/a	0- 20 milion lekë	5,166,353.0 Lek
NP – 7 A	Ujsjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje	Ne teresi projekti eshte ne kuader të mbrojtjes të qytetit të Bilishtit nga ujrat e larta dhe shfrytezimin e tyre per ujitjen e tokave buqesore nje siperfaqe prej rreth 600 Ha toke.	0- 20 milion lekë	52,305,857 leke
NP – 9 B	Punime per mbrojtje lumore,sistemime hidraulike dhe bonifikime	Ne teresi ky projekt i dedikohet sistemimit te ujrave siperfaqesore dhe tokesore te cilat vijne nga pjesa e siperme e qytetit. Ndërtimi I vepres se marjes Germimi / mbushja për krijimin e seksionit te kanalit Veshja me beton e seksionit të kanalit Kalimi me tuba çeliku I rrugëve Mure me gabiona	21- 50 milion lekë	52,305,857 leke

NP - 12 A	Punime të inxhinierisë së mjedisit	<p>Gjate ndertimit të objektit referuar Raportit të VNM duhet të meren masa nga ana e Kontraktorit për të shmangur në maksimumin e mundshëm ndikimin në mjedis gjatë fazës së implementimit të projektit. Eliminimi I gjenerimit të pluhurave në ajër, shmangja e ndotjes të ujit nga perdorimi I materjaleve ose nga furnizimi I papershtatshëm me karburant I mjeteve. Në preventiv është parashikuar zeri 3.158/4a (Transport I inerteve me auto) Kontraktori duhet të transportojë ose riciklojë inertet sipas rastit në një vend depozitim të pershtatshëm për llojin e materjalit që po transportohet. Për të përmbushur të gjitha kërkesat e mesipërme Kontraktori duhet të jetë I pajisur me licensat përkatëse referuar VKM Nr. 42, datë 16.01.2008:</p>	21- 50 milion lekë	2,935,815.0
NS -18 A	Punime topogjeodezike	<p>II. PUNIME GERMIMI DHE PRITAT MALORE</p> <p>Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet</p> <p>Germim shkëmbi i coptuar me ekskavator</p>	0- 20 milion lekë	13,325,348.0

		<p>0.5 m³, shkemb, ne themele gjeresi ~2 m, me shkarkim ne mjet</p> <p>Mbushje me cakell pas mureve</p> <p><i>Gjate zbatimit te projektit duhet te behen matje dhe azhornimi i zones dhe ndjekjen e projektit me kuota te percaktuara.</i></p>		
--	--	---	--	--

2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi 1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Diplomën Universitare, Libreze pune dhe Cv.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri..

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi:Kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM-ne Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë “Pune” sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, pika 1.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

Kërkesa per Drejtuesin Teknik te punimeve në object, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në VKM-ne Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohen papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit, konkretisht: *Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që*

janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “Elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 pika 2.1“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” ku përcaktohet se: “Për vepra me vlerë, të preventivuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjesi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimit”.

Inxhinier Ndërtimi

1 (një)

Ne preventiv janë parashikuar punime për të cilat është e nevojshme kërkesa e vendosur nga Ak për një Inxhinieri i ndërtimit i cili duhet të organizojë punën në zbatim, dhe kryerjen e punimeve si dhe zbatimi i sipas projektit të zbatimit.

Mur guri mbajtes e themele, llaç çimento M50
Gabiona me rrjete teli të zinguar e gure kave 1x1x1 m
Struktura monolite betoni me çakell C 20/25
Struktura monolite betoni C 16/20

Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder

1 (një)

Terreni ku kalon kanali është pjesërisht malor i vështirë për tu gërmuar pasi shpesh here është shkëmborë dhe në disa raste kërkon përforsim shpati.Ndërhyrjet të cilat do të behen janëNdërtimi I vepres se marjes.Germimi / mbushja për krijimin e seksionit të kanalit të cullaj janë punime që kerkokojne domosdoshmerisht pranine e nje inxhinieri topograf ose profesonet ekuivalente të afte I cili do të ndjeke për të bere azhornimin e zones dhe ndjekjen e projektit me kuota të percaktuara për të ruajtur kualitetin e ndertimit të ri dhe parandalimin e devijimeve.

Inxhinier Mjedisi

1 (një)

Gjate ndërtimit të objektit referuar Raportit të VNM duhet të meren masa nga ana e Kontraktorit për të shmangur në maksimumin e mundshëm ndikimin në mjedis gjatë fazës së implementimit të projektit. Minimizimin e gjenerimit të pluhurave në ajër,shmangja e ndotjes të ujit nga përdorimi i materjaleve ose nga furnizimi i papershtatshëm me karburant i mjeteve. Kontraktori duhet të marrë masa për të sistemuar inertet dhe vegjetacionet sipas rastit në një vend depozitim të pershtatshëm për llojin e materjalit që po transportohet etj Për të përmbushur të gjitha kërkesat e mesiperme AK e gjykon të nevojshëm angazhimin e një Inxhinieri mjedisi I cili do të monitori-oje të gjitha proceset e sipërpermendura

Kërkesa për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve,bazuar në pikën 4, të Nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM-se Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën Profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë projektin e zbatimit si dhe preventivin e punimeve, sidomos ne mbrojtjet lumore ku si pasojë e kushteve klimaterike terreni është në ndryshim të vazhdueshëm, rezulton se është e domosdoshme që çdo ofertues të ketë pjesë dhe Topografe, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve.

b) Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë :

- Teknik Ndërtimi	2 (dy)
- Hekurkthyes	3 (tre)
- Karpentier	3 (tre)
- Murator	4 (kater)
- Hidroizolues	2 (dy)
- Kopshtar	2 (dy)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM-ne Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”, ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike (të cilat do publikohen së bashku me dokumentat e tenderit) Punetoret e specializuar në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të

garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Kërkesa që tabela e mesiperme të dorëzohet e plotësuar që në fazën e ofertimit bëhet për arsye që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësi verifikimi për deklaratimet e bera nga Operatorët ofertues në mënyrë që të mos krijohen vonesa në procesin e shpalljes së operatorit fitues. Kjo kërkesë nuk sjell kufizim të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik në tender, pasi informacioni i kërkuar është pjesë e dosjes së secilit prej punojësve, që ka pranë O.E.

Specialistët e mesiperme janë vendosur në përputhje me llojin e kontratës, zërat e punimeve dhe objektin që ndërtohet me një numër të mjaftueshëm për realizimin me sukses të punimeve.

1. Staf i teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit. Për të ndjekur punimet në terren dhe për të organizuar dhe kontrolluar punetoret (duke patur parasysh numrin e punetoreve në piken është vlerësuar si e nevojshme prania e 2 teknikeve të ndërtimit.

2_ Tre Hekurthyes sepse në preventive janë parashikuar punime për furnizim vendosje hekuri për veprat e artit dhe punime për ndërtim gabionash. Këto punime së bashku me zëra të tjera të parashikuar në preventiv (**III. PUNIME PËR VEPRAT E ARTIT DHE BETONIMI I KANALIT**) duhet të kryhen brenda një periudhe prej 2 muajsh referuar grafikut të punimeve. Për të garantuar realizimin brenda afateve të këtyre punimeve dhe duke marrë parasysh sasinë e volumeve të parashikuar në preventiv Ak ka arsyetuar të nevojshëm angazhimin e 3 hekurthyesve.

3.288	F V hekur betoni i zakonshëm Ø > 12mm	31.7 Ton
3.331	Gabiona me rrjete teli të zinguar e gure kave 1x1x1 m	1,642 m3

3- Tre karpentiere :Ak e ka gjykuar të arsyeshme angazhimin e 3 karpentierëve gjatë zbatimit të punimeve duke ju referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe në projektin e zbatimit. Janë parashikuar sasi të konsiderueshme punimesh për ndërtim veprash arti (ura për kembesore, ndërtim mure mbajtës, struktura prej betoni etj) në një afat të shtirë në një hark kohor prej dy muajsh.

4- Murator(kater): Në projekt janë parashikuar punime për ndërtimin e pritave dhe gabionave

6	3.331	Gabiona me rrjete teli të zinguar e gure kave 1x1x1 m
	3.323	Mur guri mbajtës e themele, llaç çimento M50

5- Hidroizolues (dy)

An-6	FV gjeotekstil 165/m2
------	-----------------------

6- Kopshtar (dy)

3.2	Prerje bime të vogla Ø-10cm
3.7	Shkulje rrenjeve bimeve të vogla

An165	F.V. Fidane shkurre dekorative "Oleander"
-------	---

- c) Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë nga (Administratori i shoqërisë), Përgjegjës i Teknik të Kantierit, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi i Teknik të Kantierit, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është e bazuar në kreun I/2.1 të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” në të cilën përcaktohet se: “Drejtuuesi teknik i punimeve në kantier sigurohet sipas rastit, drejtperdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarresit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plote, të preventivuar mbi 30 000 000 (tridhjetë) milion leke, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident me kohë pune të plote në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

- d) Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë çertifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM-ne Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”, me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të deshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa për Përgjegjës të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, mbështetet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-ne Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores - Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri të përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-ne Nr.312/2010 është përcaktuar se: “Punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.”

- e) Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin 1 (një) mjek të përgjithshëm, bazuar në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e individuale të punës,
- diplomën universitare.
- licencën përkatëse për ushtrimin e profesionit.

Nëse OE nuk kanë në stafin e tyre persona përgjegjës me aftësi dhe kualifikimet e duhura lidhur me ceshtjet e shendetit në pune (nëse nuk kanë mjek të punësuar) mund ti sigurojnë këto shërbime me anë marredhenieve kontraktore (të paraqitet kontrata e vlefshme, diploma universitare dhe licenca përkatëse për ushtrimin e profesionit) me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është percaktuar bazuar në perputhje me parashikimet e VKM 108 date 9.02.2011 "Për aftësitë që duhet të plotesojnë punëmarresit, personat dhe shërbimet e specializuara që meren me ceshtjet e sigurisë dhe të shendetit në pune" i ndryshuar sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjeksore për stafin e tyre, nepermjet punësimit të një mjeku, apo nepermjet marredhenieve kontraktore me individë apo subjekte që operojnë në këtë fushë.

f) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

- Eskavatorist 4 (kater)
- Automakinist 2 (dy)
- Shofere Kamioni 5 (pese)

(Në rastet kur mjetet/makinieritë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinierive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre", miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar .

- **Manovratoret dhe Shoferet**

Për të percaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinierive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr. 629 Datë 15.07 2015 "Për Miratimin E Manualeve Teknike Të Çmimeve Të Punimeve Të Ndërtimit Dhe Të Analizave Teknike Të

Tyre” (I ndryshuar). Konkretisht numri I drejtuesve eshte ne perputhje numrin dhe llojin e makinerive qe perkojne me oret e punes sipas zerave te analizës teknike dhe grafikun e punimeve eshte vendosur edhe numri i manovratoreve dhe shoferëve . Persa i perket numrit te shoferave, analiza e e zerave sipas manualit nuk na dikton kohen qe duhet per te transportuar materialet e ndertimit, mbetjet inerte etj

- g) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontratë, duhet të disponojnë fuqi punëtore jo me pak se 31 punonjës në fushën e ndërtimit të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Mars - Maj 2023 të deklaruar.
- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën Mars - Maj 2023 të deklaruar
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Mars - Maj 2023.

Kriteri konsiderohet i permbyllur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*”. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës e cila ka një afat prej 6 muajsh. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetime të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në kreun V, seksioni III, neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: “*Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*”.

- h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të firmosur dhe vulosur nga Administratori, te detajuar sipas zërave të preventivit (bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 6 (gjashtë) muaj.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, seksioni III, neni 39, pika 3. ku përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon me grafik, fazat dhe afatet e realizimit të punëve”

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës :

1

Nr.	Mjete	Sasia	Gjendja
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
4	Ekskavator me goma	2 copë	Në pronësi ose me qera
5	Fadrome me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
6	Autovinç	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Autobot uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
8	Rimorkiator	1 copë	Në pronësi ose me qera

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) sigurimi (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësi vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë; te vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) sigurimi (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësi vendore për të tretë (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Për Mjete/pajisje teknike e tabelës 2 si më poshtë;

2

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1	Eskavator me zinxhire	1 copë	Në pronësi ose me qera
2	Eskavator me krahe të gjata min 18 m	1 copë	Në pronësi ose me qera
3	Rrul ngjeshës min 10 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
4	Minieskavator me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
5	Çekiç pneumatik	1 copë	Në pronësi ose me qera
6	Tomak ngjeshës	2 copë	Në pronësi ose me qera
7	Pajisje topografike GPS ose ekuivalent	1 copë	Në pronësi ose me qera
8	Elektrosaldatriçe	1 copë	Në pronësi ose me qera

9	Moto gjenerator	1 copë	Në pronësi ose me qera
10	Vibrator betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
11	Betoniere kantieri	1 copë	Në pronësi ose me qera
12	Tranxhe për perpunimin e hekurit te ndertimit	1 copë	Në pronësi ose me qera
13	Kontenier ndërtimi stacionar (zyrë)	1 copë	Në pronësi ose me qera

Pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kerkesave te VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Per miratimin e Rregullores per sigurine ne kantier", si më poshtë vijon:

3

Nr.	Pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1	Helmetë mbrojtëse për kokën	25 copë	Në pronësi ose me qera
2	Jelekë me shirita fosforishtë	25 copë	Në pronësi ose me qera
3	Fikëse zjarri të lëvizshme ≥ 5 kg	2 copë	Në pronësi ose me qera
4	Tabela Sigurimi Teknik	10 copë	Në pronësi ose me qera
5	Kuti e Ndihmës së shpejtë	2 copë	Në pronësi ose me qera
6	Prozektore ndricimi naten	2 copë	Në pronësi ose me qera

Ofertuesi për Mjete/pajisje teknike, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :

Për Mjete/pajisje teknike që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

a) dokumenti që vërteton pronësinë (kontrate noteriale e blerjes / fature tatimore / dokument zhdoganimi te mjetit);

b) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

a) kontrata e qerasë; te vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi

b) dokumenti që vërteton pronësinë (kontrate noteriale e blerjes / fature tatimore / dokument zhdoganimi te mjetit);

c) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe kreut V, seksioni III, neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar . Nëpërmjet këtyre kërkesave, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit mundësive të manovrimit me mjete të rënda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj.

Per makinerite dhe mjetet e punes , lloji dhe funksioni i tyre eshte percaktuar ne baze te analizes se punimeve per cdo ze ndersa numri eshte percaktuar nga oret qe duhet te klryeje secila prej tyre per afatin e percaktuar ne grafikun e punimeve. Gjithashtu si specialiste qe njohim zonen, eshte e nevojshme te vendoset kriteri i mjeteve te specifikuara pasi objekti do te ndertohet ne nje zone me nje teren te veshtire malor e cila pozicionohet ne pjesen e sipërme te qytetit te Bilishtit dhe per te mos demtuar objekte apo asfaltet ekzistuese, eshte vendosur edhe perdorimi i eskavatoreve me goma dhe i transportiereve te mjeteve te renda.

Per te perfunduar ne kohe punimet e germimeve dhe nivelimeve referuar oreve te punes kushtezuar nga grafiku duhen 4 eskavatore. Por zbatimi i punimeve ne terren eshte dicka me komplekse nga c'ka parashikohet ne analizen e zerit . Disa punime duke ju referuar dhe sheshit te ndertimit ku do te kryhen nuk ka mundesi te kryehet nga i njeiti mjet i parashikur ne preventiv prandaj edhe quhen parashikime. Jo pa arsye jane kerkuar te kombinuara llojet e mjeteve per punimet e germimit duke permendur ketu mjetet e vogla Minieskavator, fadromë etj (Bobcat ose ekuivalent) . Persa i perket numrit te shoferave, analiza e e zerave sipas manualit nuk na dikton kohen qe duhet per te transportuar materialet e ndertimit, mbetjet inerte etj Ne keto kushte AK megjithese ka kerkuar 4 kamiona qe jane minimale per vleren e objektit, duke shtuar ketu edhe mjetet e tjera si autobot uji, kamioncina etj ka kerkuar gjithesej 5 shofera

Pra AK ka kerkuar mjetet minimale per realizimin e objektit duke mos diskriminuar operatore ekonomike.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- Çertifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit te cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- Certifikatë **ISO 45001 - 2018** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.
- Liçense lëshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (Për grumbullim, ruajtje dhe transport të mbetjeve inerte dhe urbane jo te rrezikshme), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.
- Liçense lëshuar nga QKL, “Kodi III.2.A” (Veprimtarite e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis (Auditim Mjedisor.Ndikim ne mjedis).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të

njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Me ane të këtij kriteri kërkohej që OE të deshmojnë se plotësojnë standartet e kerkuara të cilësive, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standartet e menaxhimit të mjedisit.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (Rrjeta Gabion, Peme)Për materialet e kerkuara të paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE , certifikatat e cilësive ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kerkuara në Specifikimet teknike.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, paragrafi 1, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Si dhe në pikën 6 të nenit 40 të VKM-se Nr. 285 date 19.05.2021 ” Për Miratimin e rregulave të prokurimit publik” i ndryshuar Kjo kërkesë është vendosur për të ritur sigurinë dhe garantuar autoritetin kontraktor se operatori ekonomik i ka kapacitet për të ofruar furnizim të vazhdueshëm me materialet dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e punimeve sipas zërave të preventivit.

2.3.7 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin :

- “Planin e Sigurisë në Kantier” për punimet në objekt në format sipas VKM nr.692 date 13.12.2001 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit në punë”, të ndryshuar me VKM-në Nr.742 datë 06.11.2003.

Argumentimi” Për punimet në objekt në format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit në punë, të ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003”, sipas kërkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rrugë kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

** Të gjitha dokumentat e kerkuara më sipër si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës të dorëzuara në rrugë elektronike, duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, relacioni teknik, projekti dhe preventivi i zbatimit të punimeve janë hartuar nga projektuesi, bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose

produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT